



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Nr. 148/1 Prot.

Tiranë, më 11.01.2023

**NJOFTIM**

**PËR SHPALLJE KONKURRIMI PËR VEND TË LIRË PUNE**

Në mbështetje të Ligjit nr. 98 datë 06.10.2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në cilin parashikohen kompetencat e Kryetarit të Gjykatës dhe Zëvendëskryetarit, Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995, Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar si dhe pikës 3, të Vendimit Nr. 555, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykata e Rretheve Gjyqësore”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë shpall konkurrimin për vend të lirë pune si më poshtë:

- 1. 1 (një) vend, në pozicion e punës – specialist i IT-së, kategoria ekzekutive (kategoria IV - a), me kontratë të përkohshme pune.**

**Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin e punës si më sipër është:**

Specialisti i IT-së:

1. Pajis çdo punonjës të gjykatës me akseset e nevojshme në sistemet elektronike në përputhje me detyrën e punonjësit;
2. Përgatit dhe shpall listën e gjykimeve;
3. Merret me instalimin, konfigurimin dhe troubleshooting e kompjuterave dhe networkut të gjykatës;
4. Bën kontroll periodik mujor të gjendjes së pajisjeve elektronike të gjykatës;
5. Bën një backup periodik, zakonisht ditor, të të dhënave sensitive: - Databazës së sistemit të të dhënave ARKIT; - Databazës së sistemit audio RDA; - Arkivit Qendror të Transfertës së gjyqtarëve.
6. Merret me konfigurimin e-mail, serverit të brendshëm si dhe domanit të gjykatës.
7. Ndjek përdorimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të Regjistrimit Dixhital Audio (RDA).

8. Menaxhon sistemin e brendshëm elektronik të dosjeve ARKIT: Krijimin e përdoruesve (Kryetar, Kancelar, Gjyqtar, Sekretarë, etj.).
9. Korrigjon gabimet e bëra nga përdoruesit me lejen e eprorit të gjykatës.
10. Asiston në afishimin e raporteve të ndryshme statistikore.
11. Ndryshon seksionet e gjyqtarëve në bazë të urdhrit të nxjerrë nga Kryetarja e gjykatës.
12. Ndalon publikimin e dosjeve me të dhëna tepër sensitive, siç është birësimi, etj, në webin e gjykatës.
13. Ndjek gjurmimin e çdo veprimi të kryer nga përdoruesit e sistemit.
14. Kujdeset për ngarkesën e gjyqtarëve që marrin pjesë në short.
15. Kujdeset për përditësimin e informacionit në webin e gjykatës.
16. Merret me specifikimet teknike të pajisjeve elektronike të gjykatës.
17. Merret me kopjimin e CD-ve audio të dosjeve të dorëzuara nga sekretarët.
18. Mbron të dhënat e brendshme nga infiltrimi i jashtëm përmes enkriptimit, ruajtjes së sigurtë të të dhënave, instalimit të antivirusëve dhe softeve anti spam, dhe mjeteve të tjera të nevojshme.
19. Mban kontakte me kompanitë kontraktore që ofrojnë shërbime të ndryshme suporti si, shërbimi i printimit, shërbimi i audios, shërbimi i sistemit të menaxhimit të dosjeve si dhe shërbimi i internetit.
20. Ofron informacione të ndryshme të kërkuara nga eprorët e gjykatës si, pamje filmike, aksesit i hyrje-daljeve të punonjësve, etj, nga sistemet e sigurisë të gjykatës.
21. Vlerëson infrastrukturën teknologjike në mënyrë që të ketë vazhdimësi puna sipas nevojave që kanë punonjësit e gjykatës.
22. Menaxhon veprimet ditore të sektorit të IT -së.
23. Projekton strategji të reja dhe procedura të IT-së për të rritur efikasitetin dhe për të lehtësuar punën e punonjësve të gjykatës.
24. Koordinon nevojat e punonjësve të brendshëm dhe atyre të jashtëm që janë të autorizuar nga drejtuesi i gjykatës për marrje informacioni.
25. Asiston në instalimin e hardware-ve dhe software-ve të reja, si dhe trajnon punonjësit në mënyrën e përdorimit të tyre.
26. Asiston drejtuesit e gjykatës dhe palët e treta me raporte periodike si në sistemin audio RDA, sistemin e menaxhimit të të dhënave ARKIT dhe sistemin e Sigurisë dhe Aksesit.
27. Mbikëqyr teknikët e kontraktuar me kohë të pjeshme në përmbushjen e detyrës së tyre funksionale.
28. Jep sugjerime për të përmirësuar dhe ndryshuar Sistemin Elektronik të Gjykatës.
29. Njofton eprorët në mënyrë të dokumentuar nëpërmjet intranetit për problematikat e hasura.

**Kërkesa të përgjithshme, kandidati duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e përgjithshme:**

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për te vepruar;

- c. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d. Të mos jetë i dënuar penalisht;
- e. Ndaj tij të mos jete marre masa disiplinore

**Kandidati duhet të plotësojë kriteret e veçanta si vijon:**

- a. Të zotërojë diplome në Shkenca të Teknologjisë së Informacionit ose Shkenca Kompjuterike.
- b. Të ketë përvojë pune jo më pak 1 (një) vit.
- c. Preferohet të ketë kryer internship në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës **13.01.2023** ora **16:00**, pranë zyrës së protokollit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dokumentet e mëposhtme;

- a. Kërkesë motivimi për aplikimin në vendin e punës që konkurron
- b. CV - (Jetëshkrim);
- c. Fotokopje të diplomës (përfshire edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njësimi nga MAS) të noterizuar;
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) të noterizuar;
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g. Vërtetim të gjendjes gjyqësore (të gjeneruar nga platforma e-Albania);
- h. Vërtetim banimi dhe çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtese, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- i. Vërtetim nga gjykata;
- j. Vërtetim nga prokuroria.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

**Konkurrimi zhvillohet ne dy faza:**

1. **Verifikimi paraprak**, i përmbushjes së kushteve minimale për pozicionin e punës dhe kërkesave të veçanta në shpalljen për konkurrim, do të kryhet brenda datës **16.01.2023**, në ambientet e Gjykatës dhe brenda kësaj date do të shpallet lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim dhe listat e atyre që nuk i plotësojnë këto kushtet.
2. **Intervista e strukturuar me gojë**, për kandidatët fitues të fazës së parë, do të zhvillohet më datë **17.01.2023**, ora **10.00**, pranë ambienteve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë janë:

- a. Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b. Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- c. Ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d. Ligjin nr. 96/2016 “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të RSH”, i ndryshuar;
- e. Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- f. Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat etike në administratën publike”;
- g. Ligjin nr. 9367, datë 07.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- h. VKM nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë“;
- i. Ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për Nënshkrimin Elektronik”;
- j. Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”;
- k. Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për mbledhjen e të Dhënave Personale”;
- l. Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.